



STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT

INSTITUTI KOMBËTAR I
TRASHËGIMISË KULTURORE

KOORDINATORE RISKU
AFRIDA DOMNORI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KLESTA QIRICI



QERSHOR, 2023



STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT

**INSTITUTI KOMBËTAR I
TRASHËGIMISË KULTURORE**

KOORDINATORE RISKU
AFRIDA DOMNORI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KLESTA QIRICI

QERSHOR, 2023

PËRMBAJTJA:

I.	HYRJE	3
II.	BAZA LIGJORE DHE METODIKE	4
III.	PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME	5
IV.	DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT RISKUT	7
1.	Procedura kuadër për menaxhimin e riskut të brendshëm	7
V.	QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT RISKUT	9
VI.	PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT	10
1.	Mjedisi i kontrollit	10
2.	Menaxhimi i riskut	11
3.	Aktivitetet e kontrollit	11
4.	Informimi dhe komunikimi	11
5.	Monitorimi	12
VII.	PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT	13
1.	Skema e menaxhimit të riskut	13
2.	Përgjegjësitë	14
3.	Identifikimi i risqeve bazuar në Strategjine Kombëtare për kulturën 2019-2025	17
4.	Metodologjia për identifikimin e riskut	21
5.	Lista e risqeve prioritare të <i>Institutit Komëtar të Trashëgimisë Kulturore</i>	22
VIII.	VLERESIMI I RISKUT	23
1.	Matrica e riskut	24
2.	Analiza e riskut	25
3.	Regjistri i riskut	27
4.	Adresimi i riskut	30
IX.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	31
1.	Sistemi i raportimit	31
2.	Auditimi i brendshëm	31
3.	Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë	31

I. HYRJE

MENAXHIMI I RISKUT NUK ËSHTË ARMIK I NDRYSHIMIT POR ËSHTË AGJENT I NDRYSHIMIT. AI MUNDËSON DREJTUESIT PËR TË KRIJUAR MUNDËSITË DHE ARRITUR REZULTATE TË SUKSESSHME

(ZMMS/SOLACE, Chance or Choice, July 2000).

Nisur nga citimi i mësipërm *Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore*, në kuadrin e zbatimit të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” realizuar Strategjinë e riskut.

Kjo Strategji u finalizua mbas një analize studimore, trajnimit dhe vlerësimit të Riskut në Menaxhimin e Financave nga punonjësit e strukturave drejtuese të *Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut dhe është ndërtuar si pjesë e pandarë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) për *Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* duke menaxhuar risqet në vendimmarrje, vendosjen dhe arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës në shërbime.

Dokumenti përcakton standartet që duhen përdorur në procesin e kontrollit të shërbimeve me qëllim që të arrihet një përdorim më eficient i burimeve dhe rezultate sa më optimale në kontrollin e zbatimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Pjesë përbërëse është edhe vlerësimi sasior dhe cilësor i mekanizmave të kontrollit, raportimeve dhe proceseve për adresimin e risqeve të ndryshëm duke dhënë detaje për metodologjinë e mënyrat specifike të trajtimit të çdo tip risku.

Në mënyrë të veçantë lloje të ndryshme risqesh drejtohen nga faktorë të ndryshëm risku ndaj dhe aspektet organizative, proceset e tyre shpjegohen në mënyrë të detajuar duke përfshirë dhe alokimin e përgjegjësi, proceset operacionale si dhe skedulet dhe mjetet e sistemit të raportimit.

Menaxhimi i riskut është pjesë e drejtimit dhe është thelbësor për mënyrën se si institucioni menaxhohet në të gjitha nivelet. Menaxhimi i riskut është faktor kontribues në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit duke qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve që lidhen me një institucion dhe përfshin ndërveprimin me palët e interesuara.

Gjithashtu, ky proces merr në konsideratë kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm të institucionit, përfshirë edhe aspektin njerëzor, të sjelljes dhe faktorë kulturorë.

Menaxhimi i riskut bazohet në parimet, kuadrin dhe procesin e përshkruar në këtë dokument. Këto elementë mund të jenë prezentë tashmë plotësisht ose pjesërisht në sistemin e punës së *Institutit Komëtar të Trashëgimisë Kulturore*, megjithatë, ata kanë nevojë të përshtaten ose përmirësohen në mënyrë që menaxhimi i riskut të jetë i unifikuar, efikas dhe efektiv dhe në përputhje me objektivat strategjike të saj.

II. BAZA LIGJORE DHE METODIKE

Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i amenduar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin.

Në zbatim të ligjit, janë aktet ligjore pasuese të cilat kanë përcaktuar metodologjinë dhe hapat për ndërtimin e një sistemi të konsoliduar të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe pikërisht:

- Urdhëri i Ministrit të Financave nr 8980 dt 15/07/2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
- Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar,

Gjithashtu, në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik për IKTK, janë marrë në konsideratë:

1- **Praktikat më të mira** ndërkombëtare si Standarti ISO 31000:2018 për Administrimin e Riskut, dhe trajnimin e drejtuesve të Institutit Komëtar të Trashëgimisë Kulturore.

2-**Dokumentet strategjike** si akte normative, plane, manuale, kode, rregullore dhe urdhëra të miratuara nga Këshilli Ministrave e Ministria e Kulturës:

- VKM-së nr. 364 datë 29.05.2019 për "Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore",
- Urdhërit të Kryeministrit nr. 137, datë 21.10.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore";
- Urdhërin e Ministrit të Kulturës, me nr.344, datë 22.09.2020 "Rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore",
- Kodi i Etikës
- Plani Transparencës

3- **Ligjislacioni shqiptar,**

- Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë",
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar),

- Ligji nr.152/2015, "Për nëpunësin Civil" dhe aktet nënligjore në zbatimin e tij,
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike",
- Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",
- Ligjin nr.120/2014, "Për mbrojtjen e të dhënave personale",
- Ligji nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare",
- Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundravajtjet Administrative";
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat",
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar,
- Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit",
- Ligji nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik",
- Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile" i përditësuar,
- Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar,

III. PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME

- **"Risku"** - është efekti i pasigurisë në arritjen e objektivave dhe mund të shoqërohet me pasoja të cilat mund të jenë avantazhuese ose dizavantazhuese në varësi të situatës apo ngjarjes.
- **"Vlerësim i Riskut"** - Proçesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut, për të përcaktuar nëse risku dhe/ose madhësia e tij, janë të pranueshëm, ose të tolerueshëm.
- **"Zotëruesi i Riskut"** - është personi brenda një njësie organizative, i cili ka autoritetin dhe është përgjegjës për administrimin e riskut, brenda njësisë së tij.
- **"Zotëruesi i Proçesit"** - është personi, i cili ka përgjegjësinë parësore për kryerjen e një proçesi, në realizimin e objektivave të tij të matura përmes treguesve kryesorë të proçesit, dhe ka autoritetin dhe aftësinë për të bërë ndryshimet e nevojshme.
- **"Politikë"** - jep parimet bazë që udhëheqin institucionin, për çështje apo situata e ngjarje specifike. Këto parime përdoren si guidë gjatë vendim-marrjeve të caktuara.
- **"Propabiliteti"** është shansi që diçka mund të ndodhë. Ai mund të përcaktohet, vendoset apo matet në mënyrë objektive, ose subjektive, dhe mund të shprehet ose në mënyrë cilësore, ose sasiore (duke përdorur modele matematikore).
- **"Palë e Interesuar"** - Një person apo një organizatë që mund të ndikojë apo mund të ndikohet nga një vendim apo një aktivitet.
- **"Risk i Mbetur"** - është Risku që mbetet pasi ke implementuar një mënyrë të trajtimit/adresimit të tij, ke eliminuar/neutralizuar burimin e Riskut, modifikuar pasojat e Riskut, ke ndryshuar probabilitetin, ke transferuar ose ke mbajtur Riskun.

- **“Risku i qënësishëm/i pandashëm”** - Në standartet ndërkombëtare ISO 31000 risk i qënësishëm i referohet kryesisht në kontekstin kontabel materializimit të një risku për të cilin nuk ka ose nuk mund të ndërtohen sisteme kontrolli. Përcaktime të këtij lloji risku janë gjithashtu:
 - 1-Risku është prezent si rezultat i ambjentit/industrisë/sektorit në të cilën operon institucioni;
 - 2-Risk që nuk mund të menaxhohet apo transferohet;
 - 3- Nivel risku jashtë çdo kontrolli nga ana e institucionit;
 - 4-Risqet që lidhen me “forcat madhore”; përmbytje, zjarr, luftë etj.,.

Mënyra sesi adresohen risqet të tilla përgjithësisht është duke ndërtuar skenare “pesimistike” duke hamendësuar ndodhjen e këtyre risqeve sikurse dhe krijimin e fondeve të emergjences apo situatave të jashtëzakonshme.

- **“Strategji risku”** - Strategjia e riskut përshkruan strukturën organizative të institucionit, planin e zhvillimit strategjik dhe atë të rritjes së aktivitetit të IKTK-së në prespektivë. Ajo përcakton politika specifike të menaxhimit të riskut, vendos një kuptim të përbashkët të të gjitha hallkave drejtuese në lidhje me objektivat e menaxhimit të riskut që do të thotë është një guidë bazë për menaxhimin dhe kontrollin e riskut në IKTK. Këto politika përkufizojnë profilin e riskut që IKTK merr përgjithësisht (ose shmang) dhe shpjegojnë nivelin e “synuar” të tij (risk appetite) të shprehur dhe në buxhet në formën e nivelit të provigjioneve të planifikuara, nivelit të fitimit të parashikuar etj.
- **“Vlerësimi i riskut”** - është analiza në lidhje me nivelin e efektit në vlerë që ka çdo tip risku në performancën e IKTK-së dhe nëse ky efekt është material apo jomaterial.
- **“Metodologjia e menaxhimit të riskut”** - Përcakton format dhe nivelin e teknikave të kontrollit dhe menaxhimit për çdo tip risku.

IV. DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHMIT RISKUT

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTUORE NËPËRMJET
KËSAJ STRATEGJIE, ANGAZHONET TË SIGUROJË QË RREZIQET
IDENTIFIKOHEN DHE TRAJTOHEN ME PËRGJEGJËSI TË
PËRCAKTUAR DHE NË KOHËN E DUHUR.

Në përmbushje të kësaj deklarate, detyrimet që lidhen me realizimin e politikës së menaxhimit të riskut janë:

- Detyrim i drejtuesve të njësive të veçanta dhe programeve për monitorimin dhe verifikimin periodik të risqeve që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike.
- Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për të identifikuar riskun, për monitorimin, vlerësimin dhe adresimin e tij.
- Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
- Çdo veprim i punonjësit i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të mbështetet nga drejtuesit.
- Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.
- Me qëllim garantimin e realizimit të politikës së menaxhimit të riskut, vendoset procedura në kuadër të strategjisë së menaxhimit të riskut.

1. Procedura kuadër për menaxhimin e riskut të brendshëm

Teoria klasike e menaxhimit të riskut eidenton një ndarje klasike të risqeve si:

- (1) Rsiqe të brendëshme, të cilat shkaktohen nga faktorë/burime/ngjarje/dokumente,etj.. të vetë organizatës për të cilat duhet ndërtuar procedura të qarta të menaxhimit; dhe
- (2) Rsiqe të jashtme, të cilat shkaktohen nga faktorë/burime/ngjarje të jashtëm për të cilat organizata nuk ka fuqi/përgjegjësi/të drejtë për të ndërhyrë.

Mënyra e përshkruar më poshtë, do të jetë mënyra e veprimit në procesin e menaxhimit të riskut të brendshëm:

- a) Hartimi i Planit Vjetor të Punës të IKTK-së;
- b) Evidentimi i fushave themelore të funksionimit dhe evidentimi i zonave të riskut në kuadër të fushave të përcaktuara;
- c) Përkufizimi dhe përshkrimi i risqeve;
- d) Vlerësimi i impaktit të një risku të caktuar;
- e) Përkufizimi i probabilitetit që një risk i caktuar të ndodhë;
- f) Caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës të caktuar;
- g) Zbatimi i planeve/regulloreve/kodve të miratuara nga Ministria e Kulturës dhe titullari i IKTK:
 - VKM-së nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”,

- Urdhërit të Kryeministrit nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- Urdhërin e Ministrit të Kulturës, me nr.344, datë 22.09.2020 "Rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore",

h) Kodi i Etikës

i) Plani Transparencës

j) Hartimi i :

1. Rregullores për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;
2. Rregullores së Menaxhimit të Aseteve Kompiuterike
3. Planit për përballimin për Emergjencat Civile të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore “IKTK” Nr.2553 prot., dt. 04.12.2022.
4. Procedurave Standarte të Veprimit
5. Regjistrin të Riskut, ku të përcaktohen:
 - Impakti dhe probabiliteti që një risk i caktuar të ndodhë;
 - Përgjigja ndaj riskut – masa parandaluese, duke përfshirë ato që tashmë janë zbatuar dhe ato që janë të domosdoshme në të ardhmen (të planifikuara),
 - Caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës të caktuar dhe njësive vartëse,
 - Përgatitja e matrices së regjistrin të riskut.

V. QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT RISKUT

QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT ËSHTË IDENTIFIKIMI I FUSHAVE TË RISKUT, VLERËSIMI I RISKUT DHE MË TEJ ELIMINIMI, APO REDUKTIMI I RISKUT NË NJË NIVEL TË PRANUESHËM DUKE KUFIZUAR KOSTOT SHOQËRORE DHE FINANCIARE NË MINIMUMIN E DOMOSDOSHËM.

Menaxhimi i riskut institucional lidhet me rreziqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave. Menaxhimi i riskut nuk është një proces linear, por ai është balancimi i një numri të elementeve të ndërthurur që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe të cilat duhet të jenë në ekuilibër me njëri-tjetrin me qëllim që menaxhimi i riskut të jetë efektiv.

Për më tepër, risqet specifike nuk mund të trajtohen në mënyrë të izoluar nga njëri-tjetri, menaxhimi i një prej risqeve mund të ketë një ndikim në një tjetër, apo veprimet e menaxhimit të cilat janë të efektshme në kontrollin e më shumë se një risku në të njëjtën kohë, mund të jetë i arritshëm.

Qëllimi i politikës së Menaxhimit i riskut është faktorizimi si:

- Komponent i rëndësishëm i sistemit të kontrollit të brendshëm (*pjesë esenciale për sektorin publik të vendeve kandidate dhe anëtare të BE*).
- Siguri e arsyeshme se objektivat do të arrihen.
- Garanci për ofrimin e shërbimeve me të mira publike.
- Instrument për të përmirësuar efikasitetin.
- Tregues për vendimarrje më të besueshme.
- Bazë për të mbështetur risitë.
- Kërkesë Ligjore.

VI. PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT

PARIMET E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT NË IKTK PRANOHEN TË PËRDOREN SI ORIENTIME PËR POLITIKËN E BRENDSHME TË MENAXHIMIT TË RISKUT NË INSTITUCION

Parimet e Politikës së Menaxhimit të Riskut në *Institutin Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* pranojnë të përdoren si orientime për politikën e brendshme të menaxhimit të riskut në institucion.

Parimet e menaxhimit të riskut mbështeten në pesë komponentë të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, ku vetë komponentët përfshijnë disa parime si më poshtë vijojnë:

1. Mjedisi i kontrollit

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë.

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Organi mbikëqyrës (Titullari / Nëpunësi Autorizues / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) demonstron pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Titullari / NA i njësisë publike duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e njësisë, duke mirëpërcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Njësitë publike demonstrojnë një angazhim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje dhe në mbështetje të objektivave të njësisë.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe më konkretisht në ndjekjen e objektivave të njësisë.

2. Menaxhimi i riskut

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Njësia publike identifikon risqet për arritjen e objektivave të saj në të gjithë njësinë dhe analizon risqet si bazë për të përcaktuar më pas se si duhet të menaxhohen risqet.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.

Njësia publike merr parasysh dhe vlerëson mundësinë e mashtrimit në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.

Njësia publike identifikon dhe vlerëson ndryshimet që mund të ndikojnë ndjeshëm në sistemin e kontrollit të brendshëm.

3. Aktivitete e kontrollit

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit që kontribuojnë në zbutjen e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrolli mbi teknologjinë.

Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë për të mbështetur arritjen e objektivave.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Njësia publik vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave që përcaktojnë se çfarë pritet dhe procedurat që vënë në veprim politikat.

4. Informimi dhe komunikimi

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Njësia publike merr ose gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë për kontrollin e brendshëm, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Njësia publike komunikon me palët e jashtme lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

5. Monitorimi

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta për të konstatuar nëse komponentët e kontrollit të brendshëm janë të pranishëm dhe funksionojnë.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur.

VII. PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT

1. Skema e menaxhimit të riskut

Në hartimin e dokumentit të strategjisë së menaxhimit të riskut për njësinë publike *Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* është ndjekur procedura dhe metodologjia e udhëzimeve dhe konsulencës me specialistë të Njesisë Qëndrore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financave.


Dy nga metodat e modeleve të propozuara janë:

1-Krijimi i një ekipi të caktuar: i cili do të marrë në konsideratë të gjitha operacionet dhe aktivitetet e organizatës në lidhje me objektivat e saj dhe për të identifikuar risqet që i shoqërojnë ato.

2-Vetë-vlerësimi i riskut: ku çdo strukturë e njesisë kontribuon në **identifikimin e risqeve** me të cilat ballafaqohet dhe **krijon regjistrin** e vet të risqeve.

Në hartimin e këtij dokumenti dhe në vijimsinë e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut për IKTK, është realizuar trajnimi i drejtuesve të programeve të cilët do të punojnë në identifikim e risqeve që ndikojnë në objektivat e tyre.

Skema e menaxhimit të riskut paraqet hapat që do ndiqen:



Plani i menaxhimit është një analizë komplekse ku amendohen të gjitha mundësitë e ndodhjes së riskut që pengon realizimin e objektivave të IKTK-së dhe përfshin:

1. Identifikimin e riskut, e cila ndahe në:

- Fusha e veprimtarisë IKTK-së sipas Programeve/Sektorëve,

- Fusha e riskut
 - Përshkrimi i riskut
2. Analiza e riskut, e cila ndahet në:
- Impakti i riskut (para kontrolleve)
 - Propabiliteti (para kontrolleve)
3. Përgjigja ndaj riskut, e cila ndahet në:
- Masat e marra
 - Masat e planifikuara
 - Personat përgjegjës

Modeli i mëposhtëm paraqet në formë tabelare Planin e menaxhimit të riskut që të gjithë drejtuesit e programeve/sectorëve duhet të realizojnë pas finalizimit dhe miratimit të buxhetit vjetor.

Koordinatori i riskut bën përmbledhjen e këtij plani nga secili program në një plan unik menaxhimi të riskut për IKTK:

Nr	Identifikimi i riskut			Analiza e riskut		Përgjigja ndaj riskut		
	Fusha e veprimtarisë IKTK sipas Programeve	Fusha e riskut	Përshkrimi i riskut	Impakti i riskut (para kontrolleve)	Propabiliteti (para kontrolleve)	Masat e marra	Masat e planifikuara	Personat përgjegjës
Objektivi 1- Programi Menaxhim Administrimi/Sektori I Finances dhe Shërbimeve: Krijimi i kushteve optimale të punës dhe teknologjise për realizimin e shërbimeve me korektesi.								
1	Menaxhim administrimi (Paisje kompjuterike për administratën)	Prokurime	Apelimi nga operator në tenderim/Bllokimi prokurimit/vonese në realizimin shërbimit	Lartë	Mesare	Kontroll i ecurisë së procesit të prokurimit	Parashikim për ndryshim buxheti	Drejtor i Programit

2. Përgjegjësitë

1-Titullari i njesise publike është përgjegjës për miratimin dhe monitorimin e objektivave të njesise që drejton, strategjinë e riskut dhe plan-veprimet për përmbushjen e objektivave.

2-Koordinatori i Riskut është përgjegjës për:

- *Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik permbushjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij;*
- *Këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike në bashkëpunim me NJQH/MFK;*
- *Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek Titullari dhe GMS.*
- *Monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;*


3- Grupi për Menaxhimin Strategjik GMS dhe menaxherët e tjerë të njësisë/titullarët janë përgjegjës për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

Për efekt të përcaktimit të përgjegjësi sipas funksioneve/programve/njësive/aktiviteteve në IKTK, i referohemi Strukturës oraganike të *Institutit Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* e cila është miratuar me VKM-së nr. 364 datë 29.05.2019 për “*Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*”, dhe Urdhërit të Kryeministrit nr. 137, datë 21.10.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*”;

Drejtuesit më të lartë të programeve janë Përgjegjësit e Sektorëve, të cilët janë anëtarë të Grupit për Menaxhim Strategjik. Mbi bazën e detajimit të fondeve buxhetore në Buxhetin vjetorë-2023 dhe Programit Afatmesëm Buxhetorë (PBA) 2023-2025, është realizuar puna përgatitore për identifikimin e risqeve për hartimin e Planit të Menaxhimit të riskut për vitin 2023 (shtojca nr.1)

Organigrama e *Institutit Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* paraqitet si më poshtë:

DREJTORI PËRGJITHSHËM IKTK I-4



3. Identifikimi i risqeve bazuar në Strategjine Kombëtare për kulturën 2019-2025

Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore ka miratuar Planin e Punës për vitin 2023, bazuar në Strategjine Kombëtare për kulturën 2019-2025.

Në **vizionin** e saj përcaktohet se:

ARTI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE E SHQIPËRISË, SI FORCË SHTYSE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHESHËM EKONOMIK DHE SHOQËROR TË VENDIT.

Nga përcaktimi i prioriteteve të punës me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, *Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore* ka renditur **objektivat** e skeduluara në këtë document për vitet e ardhëshme.

PRIORITETET E PUNËS IKTK	OBJEKTIVAT
<i>I. Përmirësimi i kuadrit ligjor</i> Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale. Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara.	a) Të angazhohet në hartimin e projekt akteve në bazë të Planit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP), për vitin 2023 nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës; (Të gjithë sektorët). b) Hartimi i propozimit për tarifat e shërbimeve të ofruara nga IKTK dhe paraqitja e tyre pranë Ministrisë së Kulturës, për përfshirjen në Urdhrin e Përbashkët të saj me Ministrinë e Financave; (Të gjithë sektorët) c) Hartimi i udhëzuesit për menaxhimin dhe administrimin e tarifave të shërbimit të IKTK; (Të gjithë sektorët) d) Hartimi i Strategjisë së Riskut 2023-2025 për IKTK; (Të gjithë sektorët) e) Përmirësimi i kuadrit ligjor me akte ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (DMK + DSHA): ✓ VKM për deklarimin e interesit kulturor; ✓ VKM e re Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP); ✓ VKM e rishikuar Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP); ✓ VKM për zonifikimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Beratit, Vlorës dhe Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. ✓ VKM në lidhje me zonën arkeologjike nënujore të bregdetit të qytetit të Durrësit, në bashkëpunim me IA dhe QMD. ✓ VKM për zonën Arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës dhe zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, Kalasë së Lëkurësit dhe Manastirit të 40 Shenjtorëve.
	a) Vijimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet IKTK dhe organizatës Trashëgimia

<i>II. Partneritete dhe Marrëveshje bashkëpunimi (IKTK)</i> Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira. - Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore.	Kulturore pa Kufij Shqipëri (CHëB Albania) me Nr. 502 Prot., datë 16.03.2022, për “Përmirësimin e sistemit të monitorimit të gjendjes së pasurive kulturore për priorizimin efikas të ndërhyrjeve, si dhe vlerësimin potencial të riskut në objektet e trashëgimisë kulturore materiale”, projektit i cili parashikohet të implementohet brenda një periudhe 2-vjeçare. Përditësimi i formatit të kartelave të pasurive kulturore, me qëllim përpilimin e të dhënave të tyre në format databaze digjitale, do të nisë fillimisht me Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, si projekt pilot gjatë vitit 2023, për të vijuar më tej edhe me drejtoritë e tjera. Një projekt i cili do të shërbejë për rritjen e efikasitetit në monitorimin periodik të tyre si edhe në vlerësimin e dëmeve në raste fatkeqësish. Gjithashtu, pas digjitalizimit të formatit të kartelave, projekti përfshin trajnimin e stafit teknik të DRTK-ve mbi procesin e kartelizimit digjital të pasurive kulturore (vlerësimin i gjendjes së konservimit). b) Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet IKTK-së dhe Institucioneve të arsimit të lartë, si dhe organizmave që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. c) Studimi i atelieve të pikturimit dhe përgatitja e relacioneve për ndërhyrje restauruese në bashkëpunim dhe pjesëmarrjen e specialistëve të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), Prof. Fatos Ylli sipas marrëveshjes përkatëse
<i>III. Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore</i>	a) Bashkëpunim i drejtpërdrejtë me INRAP (Institut National de Recherches Archéologiques Préventives), Francë dhe Ministrinë e Kulturës Francë për organizimin e programit/aktivitetit “DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË” në datat 16-17-18 qershor 2023, ku IKTK do të jetë në rolin e koordinatorit për Shqipërinë; (DSHA) b) Pjesëmarrje në konferencën vjetore të 24-të të EAC me temë “Menaxhimi i Trashëgimisë Arkeologjike dhe Arkeologjia e shekujve 18-20” në Bon, Gjermani. (DSHA) c) Pjesëmarrje me poster në konferencën vjetore të 29-të të EAA në Belfast me temë “Gërshetimi i rrëfimeve, Northern Ireland-DSHA). d) Konferenca 2 ditore për arkeologjinë nënujore në bashkëpunim me ICUA Zadar, UNESCO INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE – IKTK në bashkëpunim me INTERNATIONAL CENTRE FOR UNDERWATER ARCHAEOLOGY, in Zadar – (ICUA) e) Vazhdimi i punës në kuadër të bashkëpunimit me Qendrën Kombëtare për Studime Shkencore (CNRS, Centre national de la recherche scientifique, UMR 8167, Orient et Mediterranée, Paris) – Universiteti i Sorbonës-Paris IV, për projektin “Inventari i Trashëgimisë në Shqipëri, Inventari i mozaikëve në Shqipëri”, nën drejtimin e Znj. Marie-Patricia Raynaud. f) Realizimin e disa analizave shkencore jo shkatërruese, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe European Centre for Byzantine and Post byzantine Monuments, me qendër në Selanik, Greqi, bashkë me specialistë restauratorë nga European Centre for Byzantine and Post byzantine Monuments. Vijimi i hartimit të projektit : “<i>Punime restauruese në kishën e manastirit të Shën Kollit, Mesopotam</i>”(vendim Nr. 212, datë, 3.06.2022 i KKTKM).

IV.Marrëdhënie me UNESCO-n në kuadër të mbrojtjes së Pasurive Botërore në Shqipëri dhe në kuadër të zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore	a) Realizimi i draftit final të Planit për Menaxhimin e Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë. (IKTK) b) Realizim i Ëorkshop-it për prezantimin final të PMI Berat-Gjirokastrë. c) Raport i gjendjes së konservimit për pasurinë botërore të Rajonit të liqenit të Ohrit në bazë të vendimit të komitetit të trashëgimisë botërore d) Raport i gjendjes së konservimit për pasurinë botërore Berat-Gjirokastrë, në bazë të vendimit të trashëgimisë botërore. e) Komunikime bazuar në raportime të mundshme mbi investime dhe projekte zhvillimore të mundshme në territorin e pasurive botërore.
V.Aktiviteti i IKTK-së në përputhje me Planin e punës 2023	a) Pasurimi i listës së pasurive kulturore nëpërmjet një procesi studimi të thelluar kërkimor-shkencor. b) Rritja e cilësisë dhe sasisë së hartimit të projekteve të restaurimit për objekte pasuri kulturore dhe ndërhyrjen konservuese në pikturën murale, ikona dhe mozaikë, në territorin e Shqipërisë. c) Mbrojtja dhe restaurimi i veprave të artit, pikturës murale, ikonave, mozaikëve etj. d) Rritja përafërsisht në masën 10% të shërbimeve arkeologjike në terren (gërmime/sondazhe, dokumentime arkeologjike, vëzhgime arkeologjike, verifikime në terren dhe gjetje rastësore), me synim përmbushjen e veprimtarisë dhe misionit, si dhe rritjen e burimeve të financimit të DSHA-IKTK. e) Ndjekja dhe zbatimi në kohë të marrëveshjeve tre palëshe për shërbime monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve si dhe mbikëqyrjes arkeologjike gjatë realizimit të sondazheve/gërmimeve arkeologjike, në përgjigje të kërkesave dhe ritmeve të zhvillimit të projekteve nga subjektet aplikues. f) Mirëmbajtja e sistemeve ËebGis të IKTK g) Realizimin dhe ndjekjen e funksionimit të sistemit unik kombëtar të hedhjes së informacionit të shërbimeve arkeologjike në terren, mbështetur në teknologjinë GPS dhe GIS në bashkëpunim të ngushtë me (i)DSHA, (ii)institucionet shtetërore(iii) subjektet publike e private të specializuara në fushën e arkeologjisë, që janë përdorues e zhvillues të platformës digjitale ËebGIS, duke respektuar afatet ligjore respektive të çdo shërbimi. h) Realizimin e standartizimit të të dhënave të ËebGIS Monumentet dhe përgatitjen e tyre për publikimin nga ASIG.
VI.Monitorime arkeologjike	a) Monitorime arkeologjike të subjekteve private të licencuar në arkeologji- 25 në total
VII.Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM	a) Përfundimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore me qëllim menaxhimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Sekretaria Teknike e IKTK-së; b) Të mundësojë publikimin brenda një afati sa më të shkurtër të mundshëm të Vendimeve të KT-së, KKTKM-së, Regjistrave Publikë si dhe njoftimeve të ndryshme në faqen ëeb të IKTK-së;
VIII.Programe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe Kërkimi Shkencor	a) Mundësia e financimit të kurseve të trajnimit / Atelieve të Restaurimit, të propozuara nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore, nëpërmjet përmirësimit të projekt propozimeve dhe rritjes së numrit të kërkesave për financim.

IX. Botime dhe Promovime	a) Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” Nr.61 organ i IKTK-së, nëpërmjet rritjes së numrit të artikujve shkencor të hartuar nga stafi i IKTK-së (Për këtë vit do të hartohen 4 artikuj shkencorë nga IKTK: 1 SQHATP +1 SVA+ 1 SAAM+1 QRKREJ); b) Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike me veprimtarinë arkeologjike të Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik për vitin 2022;
X. “Digjitalizimi i arkivit” të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokollit për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”	a) “Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokollit për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence” duke arritur realizimin e skanimit të kartotekës së Arkivit Teknik të IKTK-së, në masën 100 %; (Arkiva Teknike)

Bazuar në këto objektiva, në politikën, rregulloret, manualët, përjasjen dhe parimet e menaxhimit të riskut të institucionit janë identifikuar risqet, të cilat kanë dy këndvështrime:

1-Pasojat e asaj që mund të ndodhë mund të jenë negative kur ato rezultojnë në humbje, dëme apo efekte negative e të padëshirueshme sikurse dhe mund të kenë efekte pozitive apo avantazhe në oportunitete. Në parim çdo ngjarje ka gjithmonë të paktën 2 këndvështrime në efektet që sjell; për një palë do të jetë pozitive dhe për tjetrën do të jetë negative ose e padëshirueshme.

2-Probabiliteti i ndodhjes/materializimit të këtyre pasojave.

Kombinacioni i këtyre dy parametrave; pasoja dhe probabiliteti i ndodhjes/ materializimit të pasojave përcakton atë që quhet **nivel i riskut**.

Disa nga pyetjet ndihmëse në diskutimet për identifikimin e risqeve në Planin e menaxhimit të risqeve janë si me poshtë:

- Është detyrë/ aktivitet/ proces/ projekt kritik për performancën e institucionit/ sektorit, etj?
- A është kjo një detyrë/aktivitet/proces/ projekt kompleks?
- Ka të bëjë kjo detyrë/aktivitet/proces/ projekt me ndonjë teknologji/metodologji të re apo të panjohur?
- A ka kjo detyrë/aktivitet/proces/ projekt ndërvarësi të shumta?
- A e kemi pasur probleme me detyra/aktivitete/procese/ projekte të ngjashme më parë?
- A është kjo detyrë/aktivitet/proces/ projekt i influencuar nga ndikimet e jashtme (lejet, entet rregullatore, etj)
- A ka burime njerëzore pa përvojë të caktuar për të performuar në këtë detyrë/ aktivitet/ proces/ projekt?
- A ka burime të mjaftueshme të caktuara në këtë detyrë/aktivitet/proces/ projekt përfshirë dhe sistemet IT (softëare dhe hardëare)?

Për përgjigjet “po” të pyetjeve të mësipërme, kalohet në pyetje në lidhje me problemet e mundshme që mund të lidhen me këtë fazë:

- Cilat çështje apo probleme mund të ndodhin?
- Çfarë problemesh kanë ndodhur me detyra/aktivitete/proçese/ projekte të ngjashme në të kaluarën?
- Çfarë mund të shkaktojë këtë problem?

Pasi keni ecur nëpër proçesin e identifikimit të gjitha risqeve të mundshme për detyrën/aktivitetin/proçesin/projektin në diskutim, fillojmë analizën e riskut për të marrë një vështrim nga afër në çdo risk të identifikuar për të parë se çfarë ndikimi ka me të vërtetë.

4. Metodologjia për identifikimin e riskut

Një risk identifikohet me fjalët:

- Humbje të
- Dështimi i
- Mungesë e.....
- Jo efektiv
- Jo efikas
- Papërshtatshëm
- Dëmtimi i
- Zhvillimi i

Për të përcaktuar fushën e burimit të riskut që sjellin si pasojë ndryshime/pasiguri në arritjen e objektivave, në ndihmë na vjen tabela e mëposhtme:

Fushat e burimeve të riskut	Ndryshime apo pasiguri si rezultat i :
Mjedisor	Lejet mjedisore, rregulloret për nivelin e zhurmave, menaxhmin e mbetjeve, opinion publik, impakti në ambjent etj
Planifikim	Kërkesat për leje, politika apo praktika aktiviteti të caktuara, përdorimi i tokës, impakti socio-politik
Tregu	Niveli i kërkesës në treg, lloji i kërkesës së klientëve
Ekonomik	Politikat e taksave, kostot, inflacioni, normat e interesit,
Financiar	Mos miratim buxheti, falimentim, niveli i marzhit të fitimit etj
Natyra	Kushte të paparashikuara të kompozimit gjeo-teknik të tokës, moti, tërmetet, zjarri apo eksplozionet, zbulime arkeologjike
Projekte	Përcaktimi, strategjia e prokurimeve, kërkesat për standartet e performancës, cilësia e kontrollit
Teknike	Disenjim i përshtatshëm, efikasitet operacionale, besueshmëria
Rregullatore	Ndryshime në kuadrin ligjor rregullator dhe administrativ

Njërëzore	Gabime, paaftësi, injoranca, lodhja, aftësitë komunikuese, kultura
Ligjore	Ndryshimet në kuadrin ligjor në përgjithësi dhe veçanti
Politik	Politika qeveritare, opinion publik, ndryshim në ideologji, dogma, legjislacioni, destabilizime (luftë, terrorizëm, vandalizëm)

Në vlerësimin që përgjegjësit e riskut duhet të bëjnë, element i rëndësishëm është dhe kategoritë e riskut në:

- **Risqet e jashtme;**

-Politike,-Ekonomike,-Social kulturore,-Teknologjia,- Ligjore/rregullatore,-Mjedisi,etj,

- **Risqet e brendshme**

-Kryerja e shërbimeve jo-cilësore, -jo-efektivitet i administrimit të burimeve njerzore-financiare, etj.,

Në çdo përshkrim risku kur ai diskutohet apo dokumentohet, duhet të jenë prezente tre komponentë:



5. Lista e risqeve prioritare të *Institutit Komëtar të Trashëgimisë Kulturore*

Nga të dhënat e raportuara nga drejtuesit e programeve në ëorkshopin e trajnimit për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, ata kanë formuluar si risqe priorotare për institucionin e *Instituti Komëtar i Trashëgimisë Kulturore*:

- Risku i realizimit projekteve të investimeve;
- Risku i procesit të prokurimit të shërbimeve dhe mallrave;
- Risku i ndryshimeve të shpeshta ligjore;
- Risku i sigurisë së sistemit IT;
- Risku i mungesës së dokumenteve regullatore të shërbimeve të ndryshme;
- Risku i sigurimit në punë të punonjësve;
- Risku i sjelljes së operatorëve në procesin e prokurimeve;
- Risku i mungesës së përshkrimit operacional të punës;
- Risku i mundësisë së transparencës ndaj publikut;
- Risku i mungesës së financimit të investimeve për projektet e hartuara.

- Risku që sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore vlefshmëria e projekteve të miratuara është vetëm 1-vit dhe pas kësaj duhet të rishikohen sërisht në rast të mosfinancimit.
- Risku i mungesës së personelit të kualifikuar për të realizuar procese pune që kërkojnë eksperiencë të gjatë në fushë, specifikisht referuar procesit të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve restauruese.
- Risku i mungesës së financimit për trajnimin e personelit dhe realizimin e kurseve/atelieve të restaurimit.
- Risku i reduktimit të personelit teknik në dy sektorët ai SAAM dhe SAQHP.
- Risku i pamundësisë së realizimit të vizitave në terren si rezultat i transportit (mungesë mjeti transporti).
- Risku i mungesës së fondeve për rinovimin e shërbimit të mirëmbajtjes së databasës së dedikuar dhe serverave të Arkivit Teknik;
- Risku i mungesës së fondeve për mirëmbajtjen e Platformave Digjitale IKTK - ËebGIS Monumentet & ËebGIS Arkeologjia.

Për sa më sipër, në këtë dokument strategjik do përcaktohet Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë së riskut.

VIII. VLERESIMI I RISKUT

Pas këtij përcaktimi, për realizuar sa më saktë vlerësimin e riskut, duhet të shqyrojmë tre element të rëndësishëm:

- 1-Të sigurohemi që ka një proces të strukturuar qartë në të cilin si mundësia e ndodhjes dhe ndikimi janë konsideruar për çdo risk;
- 2-Regjistrimi i vlerësimit të riskut në një mënyrë që lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioritetëve të riskut;
- 3-Të jetë i qartë dallimi midis, riskut të natyrshëm dhe riskut të mbetur.

Vlerësimi duhet të paraqitet sa më shumë të jetë e mundur në një evidencë të paanshme të pavarur, duke marrë në konsideratë aktoret që të preken nga risku, dhe të shmangur vlerësimin konfuz objektiv të riskut me gjykimin në lidhje me pranueshmërinë e riskut.

Ky vlerësim duhet të bëhet duke vlerësuar si mundësinë e ndodhjes së riskut dhe ndikimit në qoftë se risku është realizuar.

Një kategorizim i nivelit minimal të kategorizimit të riskut në lidhje me secilin rast është sipas vlerësimit në:

- të lartë
- të mesme
- të ulët

1. Matrica e riskut

Probabiliteti i ndodhjes dhe impakti që sjell si pasojë çdo risk i identifikuar bëhet në **matricën e riskut**.

Vlerësimi me këto dy dimensione, probabiliteti dhe impakti, sipas vlerësimit të personit përgjegjës të riskut i refrohet një përlogaritje llogjike objektive ku:

- I lartë/shume i lartë – më i madh se <70%> *Probabiliteti i ndodhjes*
- Mesatar – midis <30%> dhe <70%> *Probabiliteti i ndodhjes*
- I ulët/shume I ulët – nën <30%> *Probabiliteti i ndodhjes*

Nuk ka asnjë standard absolut për shkallën e matricës së riskut. Në rastin e përmbledhjes së të gjitha vlerësimeve të risqeve ndaj realizimit të objektivave/ programeve/ aktiviteteve/ shërbimeve/dokumenteve, etj., koordinatori i riskut pasqyron në mënyrë korrekte të gjitha vlerësimet e kategorizimit të risqeve nga personave përgjegjës në matricën e riskut. Çdo risk ose risqe për secilin objektiv të IKTK-së i ndarë në programet/sectorët zbatues, merr një numër unik dhe risku i vlerësuar për këtë pasqyrohet në matricë me të njëjtin numër në qelizën e matricës përkatëse sipas vlerësimit:

- në boshtin e abshisave është probabiliteti i ndodhjes së riskut të vlerësuar dhe
- në boshtin e ordinatave niveli i impaktit të vlerësuar.

Për identifikimin dhe pasqyrimin e të gjitha risqeve të Planit të Menaxhmit të Riskut të IKTK-së në matricën e riskut, koordinatori evidenton përparësinë e ndjekjes së risqeve.

Për të bërë më evidente rëndësinë e hartëzimit dhe ndjekjes së risqeve, hartuesit e kësaj teorie kanë përdorur si tregues ngjyrat e semaforit "dritat e trafikut" që sqarojnë rëndësinë e risqeve. Koordinator i emeton numrat nga qeliza 3X3 me numër 1 e ngjyrë portokalli, ku mendohet që si probabiliteti ashtu edhe impakti janë të vlerësimit të lartë, dhe vijon me rradhë, deri tek qeliza 1x1 me numër 9 e ngjyrë të gjelbër, ku si probabiliteti ashtu edhe impakti janë të vlerësimit të ulët.

IMPAKTI	Lartë	6	3	1
	Mesatare	8	4	2
	Ulët	9	7	5
		Ulët	Mesatare	Lartë
PROBABILITETI				

Në legjendën e matricës, koordinatori përcakton për secilën objektivë pozicionin në matricë p.sh:

- Në vlerësimin me nr.1 përfshihet:
 - 1- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 2- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 3- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
- Në vlerësimin me nr.2 përfshihet:
 - 1- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 2- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 3- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
- Në vlerësimin me nr.3 përfshihet:
 - 1- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 2- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 3- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.

e me rradhë deri në vlerësimin e fundit:

- Në vlerësimin me nr.9 përfshihet:
 - 1- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 2- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.
 - 3- risku me numerr x, programit y dhe objektivit z,.

Harta e riskut e paraqitur në matricën e mësipërme me specifikimet në legjendë për secilin risk/program/objektiv, përcakton zonat e riskut, me peshë dhe impakt të ndryshëm që përcaktojnë edhe prioritetet:

1. Zona me prioritet absolut, që kërkon kontrollin permanent të Drejtorise/Njesisë XXX,
2. Zonë me rëndësi të madhe, që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme,
3. Zonë me rëndësi të madhe, por ka pak të ngjarë të ndodhë – kontrolli ciklik,
4. Zonë me rëndësi të madhe që kërkon kontroll të vazhdueshëm nga ana e nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,
5. Zonë me rëndësi, që kërkon mbikëqyrje ciklike të nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,
6. Zonë potencialisht e rëndësishme, por me pak probabilitet që të ndodhë,
7. Zonë kërcënimesh jo shumë të rëndësishme, që kërkon monitorimin në nivel punonjësish,
8. Zonë kërcënimesh pak të rëndësishme që kërkon vetëm mbikëqyrje sporadike dhe raportim në periodha kohore të distancuara nga njëra-tjetra.
9. Zonë kërcënimesh thuajse të parëndësishme.

2. Analiza e riskut

Në përfundim e planit të menaxhimit të riskut, matricës së riskut dhe hartëzimit të tij në nivelin e përgjithshëm, duhet të kalkulohet risku total dhe analiza e tij. Në analizën e riskut, na vjen në ndihmë kjo tabelë analitike:

Impakt/ Probabilitet	Kosto	Koha	Cilësia
Shumë i ulët	E menaxhueshme duke koordinuar zërat brenda punës/programit/buxhetit	Shmangie e lehte nga objektivi kohor i vendosur	Reduktim i lehtë në cilësi/qëllim, por jo impakt në aktivitet
I ulët	Kërkon burime njerzore /fonde/afate/ shitesë nga institucioni	Shmangie e lehtë kundrejt pikave kritike të projektit	Dështim në përfshirjen e disa elementëve cilësorë të projektit
Mesatar	Kërkon burime njerzore / fonde/afate/ të konsiderueshme nga institucioni	Vonesat kanë ndikuar disa nga pjesëmarresit/ hallkat e procesit dhe rrezikohet besimi në zbatimin me eficiencë të shërbimit.	Mungesë e konsiderueshme e elementeve funksionale të shërbimit – dështim në objektivat kryesorë
I lartë	Kërkon rishpërndarje/ rialokim/rivendosje të konsiderueshëm të burime njerzore / fonde/afate të institucionit	Dështim për të respektuar afatet me planin	Dështim në shkallë të lartë i objektivave të shërbimit.
Shumë i lartë	Rritet konsiderueshem kercenimi mbi ecurinë e procesit	Vonesat kanë prekur ecurinë dhe rezultatet e procesit	Sherbimi nuk funksionon.

Në përgjigje të vlerësimit të saj, zhvillohet strategjia e mitigimit (lehtësimit) dhe një plan “B” nese risku materializohet, në të cilën analizohet:

- efektiviteti i strategjisë së përzgjedhur,
- si është adresuar menaxhimi riskut,
- sa është reduktuar probabiliteti dhe impakti.

Menaxhimi i riskut është proces fluid dhe i vazhdueshëm pasi e tillë është dhe natyra dhe dinamika e risqeve nga këndvështrimi i probabiliteteve apo impaktit që ata kanë në evente të caktuara në momente dhe ambiente të caktuara.

Duhet kujdes me presionin hierarkik apo pozicional që nuk duhet të influencojë nivelin e vlerësimit të risqeve që identifikohen. Njerëzit tentojnë të mos pranojnë që, proceset që janë nën menaxhimin apo kontrollin e tyre, të shkojnë keq dhe përgjithësisht marrin pozicionin mbrojtës ose agresiv për të mos pranuar vlerësimin e nivelit të risqeve përkatëse në refleksion të egos personale dhe/ose pozicionale.

Duhet të bëhet kujdes tek risqet të cilat kanë lidhje me njëri-tjetrin sepse edhe pse probabiliteti i ndodhjes së tyre mund të jetë i vogël, impakti për efekt korrelacioni të tyre mund të jetë i konsiderueshëm. Risqet e vogla nuk duhen injoruar, por adresuar në mënyrë efikase.

3. Regjistri i riskut

Rregjistri i Riskut është mjeti ku depozitohen të dhënat mbi risqet e identifikuar, seriozitetin e tyre dhe veprimet, hapat që do të merren për ti adresuar ata respektivisht. Ai mund të jetë një dokument i thjeshtë ose një tabelë që paraqet të gjithë informacionet në vetëm disa faqe. Menaxherët/drejtuesit/përgjegjësit e riskut duhet të shohin regjistrin e riskut si një mjet menaxhimi të rishikimit dhe përditësimit të proceseve të ndryshme që identifikon, vlerëson dhe menaxhon risqet për të qenë në nivele të pranueshme. Rregjistri ofron një kornizë në të cilën problemet që kërcënojnë aktivitetin/institucionin janë paraqitur dhe shoqëruar me veprimet adresuese për të reduktuar probabilitetin dhe ndikimin e mundshëm të risqeve të veçanta. Rregjistri i prezantohet në frekuenca të përcaktuara stafit manaxherial të institucionit në mënyrë që të njihet me risqet që janë identifikuar dhe mënyrat e adresimit për trajtimin e tyre.

Komponentët e Rregjistrit të Riskut janë:

- Emrin e Institucionit
- Misionin e Institucionit
- Objektivat e Institucionit
- Pershkrimin e riskut
- Niveli i riskut parakontrollit (ndikimi /probabiliteti)
- Kontrollet ekzistuese
- Risqet pas kontrolleve ekzistuese
- Nevoja për kontrolle të mëtejshme
- Veprime për të adresuar boshlleqet
- Zotëruesi i riskut

Permbajtja e regjistrit të riskut paraqitet si më poshtë:

1. Informacioni bazë për riskun, i cili detajon:

- Nr.Riskut (*numër unik për çdo risk të trajtuar*)
- Pershkrimi riskut (*ngjarja → pasoja → impakti*)
- Përgjegjes (*pozicioni, emër mbiemër*)
- Data e raportuar
- Data e fundit e rishikuar

2. Informacionin mbi vlerësimin e riskut, i cili detajon:

- Impakti (*L-lartë/M-mesëm/U-ulët*)
- Pershkrimi i impaktit (*ngjarja e matëshme-impakti i matshëm*)
- Probabiliteti (*L-lartë/M-mesëm/U-ulët*)
- Koha (*A-afër/M-mesëm/L-lartë*)

- Statusi i përgjigjes *(N (pa plan); P (Plan, por nuk është miratuar); PE (Plani i miratuar por efektiviteti ende i panjohur); EE (Plani i miratuar dhe efektiv))*

3. Informacion mbi përgjigjen kundrejtë riskut, i cili detajon:

- Veprimet e kryera
- Veprimet e planifikuara në të ardhemen
- Statusi i Riskut; Hapur/Mbyllyr/Materializuar me problem

E rëndësishëm është që regjistri i riskut të jetë:

- I kuptueshëm
- Struktura e mirë dhe e dobishme
- E paraqitur qartësisht
- Lidhje të qarta me regjistra të nivelit më të ulët nga fokus me diskutimet e GMS
- I unifikuar nga njësite shpenzuese/ programet/ për tu përiditësuar lehtësisht nga koordinatori riskut të IKTK-së

Rregjistri i riskut bashkëlidhet në shtojcën nr.2 dhe modeli i mëposhtëm jep shembullin e një risku klasik të plotësuar:

RREGJISTER RISKU VITI 2023

IKTK

Informacioni baze per riskun					Informacion mbi vleresimin e riskut					Informacion mbi pergjigjen kundrejt riskut		
Nr.Riskut	Pershkrimi riskut	Pergjegjes	Data e raportuar	Data e fundit e rishikuar	Impakti (L/M/U)	Pershkrimi I impaktit	Propabiliteti (L/M/U)	Koha (A/M/L)	Statusi I pergjigjes (N/ P/ PE/EE	Veprimet e kryera	Veprimet e planifikuara ne te ardhemen	Statusi I Riskut; Hapur/Mbyllyr/Materializuar me problem
Vendosni nje nr unik per cdo risk te trajtuar	Çmimi i karburantit mund te ngrihet, kostoja e shpenzimeve administrative shkon ne buxhet/ sherbimi nuk mund te realizohet ne masen e parashikuar	Pergjegjesi i Sektorit te Finances dhe Sherbimeve	25.03.2023	15.04.2023	Mesem	Kostoja e karburantit mund te kete rritje mbi 50% te cmimit aktual qe mund te rezultojne ne tejkalim buxheti 15% mbi parashikimin	Larte	Afer	P-Plani, por nuk është miratuar	10-Prill-2023: ju kerkua Keshillit Bashkiak rishikim buxheti; kerkesa u refuzua	12-Prill-2023: vleresim te koston se perdorimit te Karburantit per mjetet sipas drejtorive te sherbimeve dhe u rishikua numri I levizjeve	Materializuar me problem per tu mbajtur nen monitorim

4. Adresimi i riskut

Risqet e identifikuara mund të zvogëlohen ose kufizohen nëpërmjet futjes së aktiviteteve të duhura të kontrollit. Këto mund të jenë:

- **Kontrollet parandaluese** të konceptuara për të reduktuar mundësinë e ndodhjes së riskut (të tilla si ndarja e detyrave, kufij të qartë të delegimeve të autorizuar);
- **Kontrolle korrigjuese** të konceptuara për të korrigjuar rezultatet e padëshiruara (të tilla si recuperimi i pagesave të pasakta);
- **Kontrolle Udhëzuese** të konceptuara për të garantuar që një rezultat i veçantë është arritur (të tilla si masat e sigurisë apo kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe jetës);
- **Kontrolle Zbuluese** të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (të tilla si kontrolle të mallrave apo aktiveve, apo procedurat e rakordimit).


Ne se nga analizat e kryera rezulton se masat e marra deri më tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedura dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët probabiliteti. Por gjithashtu duhet mbajtur mend se reagimi ndaj riskut mund të marrë forma të ndryshme:

1- **transferimi** – kalimi i riskut tek një subjekt/shërbim/program tjetër,

2- **tolerimi** – mundësitë e kufizuara për veprim, p.sh. veprimet e kufizuara deri në minimumin e kërkuar nga fusha e kompetencave, apo nga akti ligjor, që ngarkon përmbushjen e qëllimeve të caktuara; kosto të larta të pasojave të mundshme të kristalizimit të një risku të caktuar;

3-**veprimi** – grupi më i shumtë, qëllimi: dobësimi i riskut deri në nivelin e pranueshëm, veprimet e ndërmarra në IKTK të përfshira të gjithë programet dhe drejtuesit dhe me mbikqyrjen edhe nga kontrolli i brendshëm, i cili i atribuohet një nivel të caktuar drejtimi, në përputhje me nivelin e kompetencave dhe me nivelin e impaktit të një risku të caktuar.

Është e rëndësishme të përfshihen të gjithë në proces. Skema e këtij procesi paraqitet:



IX. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Menaxhimi i riskut nënkupton jo vetëm identifikimin dhe vlerësimin e riskut si dhe identifikimin dhe zbatimin e kontrolleve të përshtatshme, por edhe monitorimin e vazhdueshëm dhe raportimin mbi kushtet e tij. Kjo ndihmon për të ndjekur procesin, nëse risqet janë menaxhuar me sukses, pra nëse aktivitetet (veprimtaritë) e kontrollit i kanë minimizuar risqet korresponduese si dhe nëse objektivat e rrezikuara, janë përmbushur. Monitorimi evidenton gjithashtu, cilat risqe janë bërë më kërcënuese dhe cilat janë pakësuar.

Është kjo një etapë që i jep titullarit të IKTK-së liri të plotë në përzgjedhjen dhe vlerësimin e mjeteve dhe metodave të mbikëqyrjes mbi procesin e menaxhimit të riskut. Është shumë e rëndësishme që menaxhimi i riskut të bëhet pjesë e kulturës së përditshme të performancës së drejtimit në çdo njësi shpenzuese.

Dy metoda themelore për garantimin e një kontrolli efektiv të risqeve janë:

1. Sistemi i raportimit

Pergjegjesit e programeve në IKTK bazuar në informacionin që merr nga strukturat e njësisë, raporton çdo tre muaj, pranë koordinatorit të riskut të IKTK, lidhur me menaxhimin e riskut brenda njësisë që drejton.

Koordinatori i njësisë publike, nëpërmjet raporteve të përgatitura Pergjegjesit për menaxhimin e riskut e programeve në IKTK, raporton çdo gjashtë muaj tek Drejtori i Përgjithëm dhe Grupi për Menaxhimin Strategjik.

Përveç kësaj, në situata kur ndodhin ngjarje të caktuara, të cilat kanë ndikim tek menaxhimi i riskut të brendshëm, çdo punonjës ka detyrimin për të informuar lidhur me këtë fakt Koordinatorin e Menaxhimit të Riskut ose eprorin e tij të drejtpërdrejtë. Në rastin e informimit të eprorit të drejtpërdrejtë, ky i fundit ka detyrimin të informojë lidhur me sa më sipër Koordinatorin.

2. Auditimi i brendshëm

Formë tjetër e monitorimit janë auditimet që kryhen nga struktura e posaçme në Ministrinë e Kulturës të cilat do të çojnë në përmirësimin e praktikave nëpërmjet rekomandimeve. IKTK është institucion i varësisë së Ministrinë e Kulturës, dhe si i tillë auditohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës (NJAB), e cila, gjatë auditimeve të kryera në IKTK, jep garanci nëse risqet po menaxhohen nga njësitë shpenzuese në mënyrë efektive. Gjithashtu siguron këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme për IKTK.

3. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë

Në përfundim të këtij dokumenti është hartuar edhe plani i veprimit për ndërrmarjen e aktiviteteve të përcaktuara për minimizimin e risqeve të evidentuara si prioritare për njësinë publike.

Faktorët që e favorizojnë lindjen e një risku në bashki evidentohen si:

- Dështimet në arritjen e qëllimeve në të kaluarën si mosrealizimi i detyrës ose qëllimit, tejkalimi i shpenzimeve të planifikuara, mosrealizimi i planit të të ardhurave;
- Parregullsi në të shkuarën si shpenzime të parregullta, cënimi i procedurave, shkelja e ligjit, mungesa e rregulloreve të brendshme, mos zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe auditimit të brendshëm, etj.,
- Faktorët e riskut të lindur (të brendshëm): karakteri i veprimtarisë, numri i punonjësve, numri i transaksioneve, specifikat e territorit ku zhvillon aktivitetin, etj.

Faktorët e risqeve që rradhitëm më sipër, përbëjnë element të rëndësishëm në Strategjinë e menaxhimit të riskut, të cilat duhet të vendosen në Planin për realizimin e Strategjisë, si aktivitete me strukturat përgjegjëse dhe afate të përcaktuara brenda peruidhës së legjitimitetit të kësaj strategjie, si më poshtë vijon:

Nr.	Aktiviteti	Strukturat përgjegjëse	Periudha e realizimit
1.	Trajnimi i përgjegjësve të Sektoreve të IKTK në fushën e menaxhimit të riskut	Drejtorët e DMK dhe DSHA	Brenda muajit tetor 2023
2.	Hartimi Regjistrir të riskut për vitin 2023	Koordinatori riskut	Brenda muajit Qershor 2023
3.	Përmirësimi i regjistrir të riskut	Koordinatori riskut	Brenda muajit Tetor 2023
4.	Hartimi i Rregullores për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës	Të gjitha drejtoritë	Brenda muajit dhjetor 2023
5.	Hartimi i Rregullores së Menaxhimit të Aseteve Kompiuterike	Drejtorët e DMK dhe DSHA	Brenda muajit dhjetor 2023
6.	Përditësimi i Planit për Përballimin për Emergjencat Civile të IKTK-së	Drejtorët e DMK dhe DSHA	Brenda muajit dhjetor 2023
7.	Hartimi i Procedurave Standarte të Veprimit	Drejtorët e DMK dhe DSHA	Brenda muajit dhjetor 2023
8.	Trajimi i punonjësve të rinj për menaxhimin e riskut	Sektori i Financës dhe shërbimeve	Vazhdimisht

Strategjia e menaxhimit të riskut për IKTK është dokument që përditësohet me përpunimin e Strategjisë së Risktu të Ministrisë së Kulturës.